39. Agim Vinca “Alternativa letrare shqiptare” (Botim i Dytë), Shkupi, Shkup, 1995	1	
40. Thoma Kacori “Ndriçime” (botim i dytë). Shkupi, Shkup, 2006	1	
41. Fadil Raka. “Çështje të shqipes letrare” Shkupi, Shkup, 1998	1	
42. Agim Vinca “Alternativa letrare shqiptare” (Botim i Dytë), Shkupi, Shkup, 1995	1	
43. Irina Voronina, Marina Domosileckaja, Lubov Sharapova “E folmja e shqiptarëve të Ukrainës” (Botim i Dytë), Shkupi, Shkup, 2005	1	
44. Nermine Vlora Falacki “Gjeneza e gjuhës shqipe”. Shkupi, Shkup, 2003	1	
45. Skender Asani “Kryengritja e përgjithshme shqiptare e vitit 1912 : (Janar-Gusht) : sipas burimeve bullgare” Shkupi, Shkup, 2010	1	
46. Skender Asani “Bibliografi për Shkupin = Библиографија за Скопје = Bibliography of Shkupi (Skopje)” Shkupi, Shkup, 2009	1	
47. Ibrahim Krosi “Baladat popullore shqiptare dhe maqedonase (folkloristikë)” Shkupi, Shkup, 2006	1	

48. Nehat Sadiku “Turbulenca politike : roli i komunitetit ndërkombëtar në çështjen e Kosovës, Kosovës lindore dhe Maqedonisë “ Shkupi, Shkup, 2004	1	
49. Teuta Arifi “Feminizmi ekzistencialist” Shkupi, Shkup, 1997	1	
50. Nehat Sadiku “Demokracia në perendim”, Shkupi, Shkup, 2005	1	
51. Qani Nuhiu “Absurde” : (analiza politike) Shkupi, Shkup, 2004	1	
52. Haki Ymeri “E folmja shqipe e Karshiakës” Haki Ymeri Shkupi, Shkup, 1997	1	
53. Remzi Nesimi “Çështje gjuhësore” Shkupi, Shkup, 1997	1	
54. Nuhi Vinca “Mbi poetikën e folklorit shqiptar : (studime dhe artikuj)” Shkupi, Shkup, 1996	1	
55. Nuhi Vinca “Antologji e lirikës popullore shqiptare të dashurisë” Shkupi, Shkup, 2001	1	
56. Nehas Sopaj “Paralelet letrare”. Shkupi, Shkup, 1998	1	
57. Sami Krosi “Mëkatet filozofike-shkencore, të Rexhep Qosjes së ri” Shkupi, Shkup, 2001	1	
58. Arben Jajaga “Arti i Talies në podiumet dibrane : [historik i teatrit në Dibër]” Shkupi, Shkup, 2000	1	
59. Ibrahim Krosi “Folklori shqiptar në kontekst ballkanik” Shkupi, Shkup, 2000	1	
60. Abedin Krosi ” Pellazgo-shqiptarët” Shkupi, Shkup, 2012	1	
61. Skender Asani “Edukata dhe arsimi nëpër shekuj : (studime dhe artikuj)” Shkupi, Shkup, 1997	1	
62. Shefki Ollomani “Leka i madh : (Aleksandri i Maqedonisë) : rrënjët e vërteta” (botim i dytë) Shkupi, Shkup, 2015	1	
63. Ibrahim Krosi “Qemal Skënderi dhe NDSH-ja në Derven të Shkupit” Shkupi, Shkup, 2002	1	
64. Skender Asani “Shqiptarët e Shkupit : ndër shekuj”, Shkupi, Shkup, 2009	1	

65. Fadil Curri “Hani i Elezit : leksikor me frazeologji” Shkupi, Shkup, 2013	1	
66. Fadil Curri “Pallë kritike mbi qepallën agonike : (refleksione, ide, skica e recensione)” Shkupi, Shkup, 2015	1	
67. Sefer Musliu, Daut Dauti “Shqiptarët e Ukrainës : [udhëpërshkrime dhe punime shkencore]” Shkupi, Shkup, 1996	1	
68. Qerim Lita “Naçërtania K. Cërvenkovski dhe identiteti shqiptar në Maqedoni (1945-1954) : (rrethanat arsimore, kulturore, politike, fetare dhe organizative). V. 1”, Shkupi, Shkup, 2007	1	
69. Abedin Krosi “Gjurmët e të kaluarës shqiptare në Derven”, Shkupi, Shkup, 2005	1	
70. Shefki Ollomani “Atlantida, Pellazgjia dhe Iliria”, Shkupi, Shkup, 2013	1	
71. Nezir Myrta, “Iliristika” (ghuhësi), Shkupi, Shkup, 2007	1	
72. Agim Vinca “Shqiptarët - mes mitit dhe realitetit : shënime rreth historisë, mendësisë dhe politikës shqiptare” Shkupi, Shkup, 1997	1	
73. Fadil Curri “Muzat e Hanpencit”, Shkupi, Shkup, 2002	1	
74. Rilind Dauti “Paradiplomacia në Ballkanin Perëndimor, Autori, Shkup, 2021	1	
GJITHSEJ PIKË	37	
Mësim / ligjërrata në institucionet e arsimit të lartë në ciklin e parë/ të dytë/ të tretë 0,04/ 0,05/ 0,06 x numri i orëve në 0,04/ 0,05/	0,04/ 0,05/	
1) 24 orë Ligjërratë në Universitetin “Nëna Tereze” Shkup, Lënda: Etika ndërkulturore. Grupi: Media	0.96	
2) 26orë Ligjërratë në Universitetin “Nëna Tereze” Shkup, Lënda: Multikulturalizmi evropian. Grupi: Sport	1.04	
3) 26orë Ligjërratë në Universitetin “Nëna Tereze” Shkup, Lënda: Multikulturalizmi evropian. Grupi: Administratë	1.04	
4) 26orë Ligjërratë në Universitetin “Nëna Tereze” Shkup, Lënda: Multikulturalizmi evropian. Grupi: Studime Ballkanike	1.04	
GJITHSEJ PIKË	4.08	

REFERENCAT KUMULATIVE TË KANDIDATIT DR. AZAM DAUTI PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE SHKENCORE:	pikët
VEPRIMTARIA HULUMTUESE SHKENCORE DHE VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE	63.00
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE DHE VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË	41.08
GJITHSEJ	104.08

Shkup, 5.9.2022

Komisioni recensues:

Prof. dr. Sefer Tahiri – kryetar, d.v.

Doc. dr. Valdeta Kasapi – anëtar, d.v.

Doc. dr. Isamet Bakiu– anëtar, d.v.

R E F E R A T
PËR ZGJEDHJEN E NJË BASHKËPUNËTORI SHKENCOR NË
DEPARTAMENTIN E MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO-OSMANE
NË ITSHKSH - SHKUP

Në bazë të konkursit publik të shpallur më 04.08.2022 në gazetata ditore “Nova Makedonija” dhe “Lajm” dhe në ueb faqen www.itsh.edu.mk, për zgjedhjen e bashkëpunëtorit hulumtues në Departamentin e marrëdhënieve shqiptaro-osmane, Këshilli i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, në mbledhjen e rregullt numër 187, të mbajtur më 22.08.2022, miratoi vendimin nr. 0201-642/3, me të cilin zgjodhi anëtarët e komisionit recensues të përbërë nga: prof. dr. Sefer Tahiri – kryetar i komisionit (ITShKSh – Shkup), dr. Valdet Kasapi – anëtare (ITShKSh – Shkup) dhe prof. dr. Ivanka Vasilevska – anëtare (Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi” – Shkup).

Duke ju falënderuar për besimin e dhënë, Këshillit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, i paraqesim këtë:

RAPORT

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, Komisionit Recensues, në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, konstatoi se për thirrjen bashkëpunëtor shkencor në Departamentin e marrëdhënieve shqiptaro-osmane të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup është paraqitur vetëm një kandidat:

Dr. Fatima Salifoska

1. TË DHËNAT BIOGRAFIKE:

Dr. Fatima Salifoska ka lindur më 30.12.1989 në Kërçovë. Shkollimin fillor dhe të mesëm e ka mbaruar në vendlindje me sukses të shkëlqyer. Në vitin 2008 është regjistruar në Departamentin e Studimeve Politike në Fakultetin Juridik “Justiniani I” në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi”, duke i përfunduar studimet në vitin 2011, ku mori titullin politolog i diplomuar.

Studimet pasuniversitare i ka vazhduar në të njëjtin fakultet, ku në vitin 2014 ka mbrojtur temën e magistraturës me temë: “Marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Turqisë në periudhën nga viti 1990 deri në vitin 2013”. Në vitin akademik 2021 ka përfunduar me sukses studimet e doktoraturës – ciklin e tretë të programit të studimit të shkencave politike në Fakultetin Juridik “Justiniani I” në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, me temën “Themelet

civilizuese të gjeopolitikës së Ballkanit në prizmin e marrëdhënieve maqedono-turke”. Kandidatja ka një përvojë pune disavjeçare në sektorin publik dhe privat. Nga viti 2021 është e punësuar në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup.

2. VEPRIMTARIA HULUMTUESE SHKENCORE

Fushat e interesit dhe kërkimit shkencor të saj janë: marrëdhëniet ndërkombëtare, diplomacia, siguria, historia politike e Ballkanit, marrëdhëniet maqedono-turke, lëvizjet migratore, politikat arsimore, multikulturalizmi dhe të drejtat e njeriut.

Dr. Fatima Salifoska është bashkë-autore e librave dhe punimeve të mëposhtme:

- „Twenty-five years at the United Nations: the Macedonian journey”, Institute for public policy, Skopje, 2021;
- „Montenegro at the annual general debate of the United Nations General assembly: (2006-2021)”, Institute for public policy, Skopje, 2021;
- „40 спортски активности и забавни игри за интегрирање на децата и младите”, Македонски центар за граѓанско образование, Скопје, 2016 (на македонски, англиски, албански, турски и српски јазик) (shq. 40 aktivitete sportive dhe lojëra argëtuese për integrimin e fëmijëve dhe të rinjve”, Qendra Maqedonase për edukim qytetar, Shkup, 2016 (në maqedonisht, anglisht, shqip, turqisht dhe serbisht).

Kandidatja gjithashtu ka publikuar punime të rëndësishme me rezultate origjinale shkencore në revista shkencore si: *Journal of European and Balkan Perspectives*, *Student's Social Science Journal*, *New Balkan Challenges*, “Gllasnik” të INK-së, si dhe revistën “Histori” e botuar nga Shoqata e Historianëve të Republikës së Maqedonisë.

Dr. Salifoska është autore dhe bashkë-autore e punimeve shkencore në vijuese:

- „The migrants crisis effect on the relations between the European Union and the Republic of Turkey”, *Journal of European and Balkan Perspectives*, vol.4, no.1, Skopje, 2021. 34-43;
- „Macedonian participation in the work of the UN General Assembly”, *Journal of European and Balkan Perspectives*, vol.4, no.1, Skopje, 2021. 22-33 (bashkë-autore);
- „The war in Bosnia and Herzegovina through the prism of the humanitarian interventions and humanitarian aid of the United Nations”, *Student's Social Science Journal*, vol. 11, no. 11, Stip, 2021. 43-55 (bashkë-autore);
- „Улогата на Европската Унија во сецесионистичките кризи во земји членки: случај Каталонија vs. Шкотска” (shqip "Roli i Bashkimit Evropian në krizat secesioniste në vendet anëtare: rasti i Katalonjës vs. Skocisë"). *New Balkan*

Challenges, year 3, number 1, Skopje: Center for International and Development Studies, 2020. 7-21;

- „Политичките импликации од мигрантската криза во Република Македонија” (shqip “Implikimet politike të krizës së migrantëve në Republikën e Maqedonisë”) *New Balkan Challenges*, year 2, number 4, Skopje: Center for International and Development Studies, 2019. 5-12;

Dr. Salifoska është autore e recensioneve vijuese:

- "Majkl D. Kallahan" Lidhja e Kombeve, Terrorizmi Ndërkombëtar dhe Politika e Jashtme Britanike, 1934-1938: (SHBA: Pellgrejv Makmillan, 2018), 317", *HISTORIA*, vëll. LIV/2019, Nr. 1, 153-157;
- "Nexhad Mehmedoviq, Maqedonia në debatin e përgjithshëm vjetor të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (1993-2018), Instituti i Politikave Publike, Shkup 2018, 168", *Гласник на ИНИ* (shq. Lajmëtar i IHK), viti 63/2019, nr. 1-2, 195-197

Kandidatja ka marr pjesë edhe në realizimin e një numri të madh projektesh, ndër të cilat më të rëndësishmet janë: “NATO.MK”, Instituti i Politikave Publike – Shkup, projekt i aprovuar nga Divizioni i NATO-s për Diplomaci Publike (NATO PDD), 2018; „USAID Interethnic Integration in Education Project”, zbatuar nga Macedonian Civic Education Center, projekt shkencor i miratuar nga USAID, 2014-2016; „Project for humanitarian and social assistance to Roma Holocaust survivors”, zbatuar nga Association for development of Roma community in Republic of Macedonia – SUMNAL, projekt shkencor i miratuar nga IOM (International Organization for Migration) dhe Roma Holocaust Survivors - Humanitarian and Social Programmes (RHS-HSP), 2013-2014; „Regional Post – ISAF Engagement: Lessons learned and a legacy for A-5 countries future expeditionary missions”, zbatuar nga Këshilli Euroatlantik i Republikës së Maqedonisë, projekt shkencor i miratuar nga Divizioni i Diplomacisë Publike të NATO-s (NATO PDD), 2013; dhe „Attitudes toward the Death Penalty in Ethnically Divided Societies: Albania, Macedonia, and Montenegro”, University of New York Tirana, projekt shkencor i miratuar nga Programi Rajonal për Promovimin e Kërkimit në Ballkanin Perëndimor (RRPP), 2010.

Në kuadër të projekteve të realizuara dr. Salifoska ka marrë pjesë edhe në ngjarje publike dhe promovuese. Ajo ishte moderatore e tribunës: “Trashëgimia Milton Friedman për Ditën e Lirisë” - Milton Friedman Legacy for Freedom Day, organizuar nga Qendra për Kërkim dhe Zhvillim të Shoqërisë VIZIO, mbështetur nga EdChoice (Fondacioni Friedman për Zgjedhje Arsimore- Milton Friedman Legacy for Freedom Day), mbajtur më 31.07.2016 në Kërçovë. Përveç kësaj, ajo ka marr pjesë në emisione të shumta televizive dhe intervista të shkruara në të cilat ka promovuar aktivitetet rrjedhëse të projektit në të cilat ishte e angazhuar.

Dr. Salifoska gjatë punës së saj ishte edhe recensuese e monografisë shkencore të Mr. Nexhad Mehmedoviq me titull: "Maqedonia në debatin e përgjithshëm vjetor të

Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara: (1993-2018)", Instituti i Politikave Publike, 2018.

Krahas arsimit formal, kandidatja ka marrë pjesë në seminare të shumta vendase dhe ndërkombëtare, konferenca, shkolla verore, trajnime, shkëmbime rinore dhe programe. Aktivitetet më të rëndësishme në të cilat ajo ka marrë pjesë janë: „Seminar on Survey Methodology“, zbatuar nga University of New York – Tirana dhe CRPM (2009); „Research methods for the social sciences“, Pristina Summer University, Pristina, Kosova (2010); „Shkolla për qytetari aktive“, zbatuar nga FORUM-CSID, mbështetur nga FOSIM dhe USAID (2012); „Shkolla e Politikave Publike |Nënë Tereza |“, realizuar nga CRPM, mbështetur nga Këshilli i Evropës (2012 dhe 2013); „Forumi Botëror i Demokracisë“, implementuar nga Këshilli i Evropës, Strasburg, Francë (2013 dhe 2019); „IV Regional School of Political Philosophy dr. Zoran Djindjic“, në organizimin e Zoran Djindjic Foundation, Beograd, Serbi (2014); „Academy for leadership“, organizuar nga BALKAN-NET, me mbështetjen e Fondacionit Hans Zajdel dhe Këshillit të Evropës (2015); „Seminar për përgjegjësinë sociale dhe promovimin e sipërmarrjes sociale“, në organizimin e APPRM dhe Instituti për Strategji Ekonomike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare - Ohër (2018); Forumi i Sigurisë në Beograd (Belgrade Security Forum) në temën: „Testing humanity“, organizuar nga Fondi i Beogradit për Përsosmëri Politike (2021) etj.

Profili shkencor i Dr. Fatima Salifoska përfshin edhe këto aktivitete:

Nga viti 2010, ajo ishte anëtare dhe më pas kryetare e bordit mbikëqyrës të AEGEE - Shkup, një nga shoqatat më të rëndësishme studentore në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” nw Shkup. Nga shkurti i vitit 2012, ajo kishte nderin të mbante postin më të lartë - presidente e AEGEE – Shkup për një mandat njëvjeçar. Kandidatja është anëtare e Kryesisë së Rinisë së Këshillit Euroatlantik të Republikës së Maqedonisë nga viti 2012 e deri më sot, anëtare e Kryesisë së Institutit për politika publike nga viti 2018 e deri më sot, anëtare e Shoqatës së Historianëve të Republikës së Maqedonisë për vitin 2021/2022, si dhe anëtare e nismës së shoqatës për siguri kibernetike dhe krijim të politikave Women4Cyber North Macedonia për vitin 2022.

3. PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur për veprimtarinë e përgjithshme të kandidatit, në përputhje me Rregulloren për kushtet dhe kriteret, procedurën dhe mënyrën e zgjedhjes në tituj arsimor-shkencorë, në përputhje me Ligjin për veprimtari hulumtuese – shkencore, Komisioni i recensues vlerëson se janë përmbushur kushtet për kandidatin që të zgjidhet në thirrjen *Bashkëpunëtor shkencor*.

Mbështetur në atë që u tha më sipër, Komisioni ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit të IPSh Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, që kandidatja dr. Fatima Salifoska, të zgjidhet në thirrjen

shkencore Bashkëpunëtore shkencore/ Docente, në Departamentin e marrëdhënieve shqiptaro-osmane.

Shkup, më 6.9.2022

Komisioni recensues

Prof. dr. Sefer Tahiri – kryetar, d.v.

Doc. Dr. Valdeta Kasapi - anëtare, d.v.

Prof. Dr. Ivanka Vasilevska - anëtare , d.v.

Shtojca:

FORMULAR
I RAPORTIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE SHKENCORE

Kandidati: **Dr. Fatima Salifoska**

Institucioni: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup
Departamenti i Marrëdhënieve Shqiptaro-Osmane

Tabela nr. 1

P. бр.	VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE DHE MËSIMORE-SHKENCORE	Pikë	
		vend.	ndërk.
1.	<i>Monografia</i>		
	1. „Twenty-five years at the United Nations: the Macedonian journey”, Institute for public policy, Skopje, 2021, 190 (bashkë-autore). ISBN 978-608-66292-3-6	6	
	2. „Montenegro at the annual general debate of the United Nations General assembly: (2006-2021)”, Institute for public policy, Shkup, 2021, 88 (bashkë-autore). ISBN 978-608-66292-2-9	6	
	3. „40 aktivitete sportive dhe lojëra zbavitëse për inegrimin e fëmijëve dhe të rinjve”, në bashkëpunim me Mitko Pishtolov, Nebojsa Mojsoski dhe Tulaha Tahir, Qendra Maqedonase për edukim qytetarë, Shkup, 2016, 94. ISBN 978-608-4529-56-9	2	
	4. „40 aktivitete sportive dhe lojëra argëtuese për integrimin e fëmijëve dhe të rinjve”, në bashkëpunim me Mitko Pishtolov, Nebojsa Mojsoski dhe Tulaha Tahir, Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar, Shkup, 2016, 94. ISBN 978-608-4529-55-2	2	
	5. „Çocukların ve genilerin entegrasyonuna ilişkin 40 spor faaliyetleri ve eğlence oyunları”, në bashkëpunim me Mitko Pishtolov, Nebojsa Mojsoski dhe Tulaha Tahir, Makedonya vatandaşlık eğitim merkezi, Üsküp, 2016, 94. ISBN 978-608-4529-58-3	2	
	6. „40 sports activities and entertainment games for integration of children and young people”, në bashkëpunim me Mitko Pishtolov, Nebojsa Mojsoski dhe Tulaha Tahir, Macedonian Civic Education Center, 2016, 94. ISBN 978-608-4529-57-6	2	
	7. „40 спортивных активности и забавных игр за интергисање деце и младих”, në bashkëpunim me Mitko Pishtolov, Nebojsa Mojsoski dhe Tulaha Tahir, Македонски центар за граѓанско	2	

	образовање, 2016, 94. ISBN 978-608-4529-59-0		
	Gjithsej	22	
2.	<i>Punim me rezultate origjinale shkencore i botuar në revistë shkencore-profesionale</i>		
	1. „The migrants crisis effect on the relations between the European Union and the Republic of Turkey”, Journal of European and Balkan Perspectives, vol.4, no.1, Skopje, 2021. 34-43	4	
	2. „Macedonian participation in the work of the UN General Assembly”, Journal of European and Balkan Perspectives, vol.4, no.1, Skopje, 2021. 22-33 (bashkë-autor)	3	
	3. „The war in Bosnia and Herzegovina through the prism of the humanitarian interventions and humanitarian aid of the United Nations”, Student's Social Science Journal, vol. 11, no. 11, Stip, 2021. 43-55 (bashkë-autor)	3	
	4. “Roli i Bashkimit Evropian në krizat secesioniste në vendet anëtare: rasti i Katalonjës vs. Skocisë”.New Balkan Challenges, year 3, number 1, Skopje: Center for International and Development Studies, 2020. 7-21	4	
	5. „ Implikimet politike të krizës së migrantëve në Republikën e Maqedonisë”. New Balkan Challenges, year 2, number 4, Skopje: Center for International and Development Studies, 2019. 5-12	4	
	Gjithsej	18	
3.	<i>Recensione të librit në revistë shkencore</i>		
	1. „Majkl D. Kallahan, Lidhja e Kombeve, Terrorizmi Ndërkombëtar dhe Politika e Jashtme Britanike, 1934-1938: (SHBA: Pellgrejv Makmillan, 2018), 317”, HISTORI, viti LIV/2019, nr.1, 153-157	0.5	
	1. „Nexhad Mehmedoviq, Maqedonia në debatin e përgjithshëm vjetor të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (1993-2018), Instituti i politikave publike, Shkup 2018, 168”, Lajmëtari i IHK, viti 63/2019, nr. 1-2, 195-197	0.5	
	Gjithsej	1	
4.	<i>Abstrakt i botuar në punimet e një konference kombëtare</i>		
	Konferenca shkencore ndërkombëtare: "Prijelomne godine Bosanskohercegovacke proslosti", abstrakt i pranuar në temën: “Ottoman – Turkish documents for crafts and trade from the last decades of the Ottoman ruling in Bosnia and Herzegovina contained in the Bulgarian Archives”, Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, 22-23.11.2019		1
	Gjithsej		1

5.	Mbrojtja e disertacionit të doktoraturës		
	Mbrojtja e disertacionit të doktoraturës në Fakultetin Juridik “Justiniani I” në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup me temë: “Themelet civilizuese të gjeopolitikës në Ballkan në prizmin e marrëdhënieve maqedono-turke” më 23.12.2021.	8	
	Gjithsej	8	
6.	Mbrojtja e tezës së magjistraturës		
	Mbrojtja e tezës së magjistraturës në Fakultetin Juridik “Justiniani I” në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup me temë: “Marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Turqisë në periudhën prej 1990 deri në vitin 2013” më 14 prill 2014.	5	
	Gjithsej	5	
7.	Pjesëmarrës në projekt shkencor		
	1., „NATO.MK”, Instituti i Politikave Publike - Shkup, projekt shkencor i miratuar nga Divizioni i NATO-s për Diplomaci Publike (NATO PDD), 2018 (hulumtues)	3	
	2., „USAID Interethnic Integration in Education Project”, implementuar nga Macedonian Civic Education Center, projekti shkencor i miratuar nga USAID, 2014-2016 (hulumtues dhe asistent projekti)	3	
	3. „Hulumtim i STEP të punëdhënësve 2014”, implementuar nga PUBLIK Shkup, financuar nga zyra e Bankës Botërore në Shkup, 2014 (hulumtues)	3	
	4. „Project for humanitarian and social assistance to Roma Holocaust survivors”, implementuar nga Association for development of Roma community in Republic of Macedonia – SUMNAL, projekti shkencor i miratuar nga IOM (International Organization for Migration) и Roma Holocaust Survivors - Humanitarian and Social Programmes (RHS-HSP), 2013-2014 (hulumtues dhe këshilltar juridik)	3	
	5. „Regional Post – ISAF Engagement: Lessons learned and a legacy for A-5 countries future expeditionary missions”, implementuar nga Këshilli Euro-Atlantik të Republikës së Maqedonisë, projekt shkencor i miratuar nga Divizioni i Diplomacisë Publike të NATO-s (NATO PDD), 2013 (hulumtues)	3	
	6. „Attitudes toward the Death Penalty in Ethnically Divided Societies: Albania, Macedonia, and Montenegro”, University of New York Tirana, projekti shkencor i miratuar nga Programi Rajonal për Promovimin e Kërkimit në Ballkanin Perëndimor (RRPP), 2010 (hulumtues)		5
	Gjithsej	15	5

8.	Totali i pikëve nga tabela nr.1	69	6
		75	

Tabela nr.2

P. бр.	VEPRIMTARIA PROFESIONALE APLIKATIVE DHE VEPRIMTARIA E INTERESIT MË TË GJERË	Pikë	
		vend.	ndërk.
1.	<i>Pjesëmarrja në shkolla verore/seminare</i>		
	1. Forumi i Sigurisë në Beograd (Belgrade Security Forum) në temën: „Testing humanity”, Beograd, Serbi, 26-28.10.2021 (virtualisht në linjë)		2
	2. Vienna Migration Conference 2021 në temën: „Re-imagining migration partnerships: Challenges, opportunities and strategies”, International Center for Migration Policy Development, 19-20.10.2021 (virtualisht në linjë)		2
	3. Forumi Botëror i Demokracisë (World Forum for Democracy) në temën: „Is democracy in danger in the information age?”, Këshilli i Evropës, Strasburg, Francë, 06 – 08.11.2019		2
	4. “Seminar për përgjegjësinë sociale dhe promovimin e sipërmarrjes sociale (certifikatë)”, organizuar nga APPRM dhe Instituti për Strategji Ekonomike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare - Ohër, Shkup, 11.09.2018	1	
	5. „Identity Fluctuations at the Crossroads of Religion, Ethnicity and Language: the Cases of Slavic Speaking Muslim Communities in the Republic of Macedonia and Kosovo”, SCOPEs, Shkup, 30.06.2018	1	
	6. „Academy for leadership (module III)”, organizuar nga BALKAN-NET, me mbështetjen e Fondacionit Hans Zajdel dhe Këshillit të Evropës, Pomorie, Bullgari, 13-16.06.2015		2
	7. „Academy for leadership (module II)”, organizuar nga BALKAN-NET, me mbështetjen e Fondacionit Hans Zajdel dhe Këshillit të Evropës, Ohër, Republika e Maqedonisë, 21-23.04.2015		2
	8. „Academy for leadership (module I)”, organizuar nga BALKAN-NET, me mbështetjen e Fondacionit Hans Zajdel dhe Këshillit të Evropës, Sandanski, Bullgari, 24-26.02.2015		2
	9. „From Master to Apprentice, a History and Culture Project”, Erasmus+, Ankara, Republic of Turkey, 12-19.12.2014		2
	10. „IV Regional School of Political Philosophy dr. Zoran Djindjic”, Zoran Djindjic Foundation, Beograd, Serbi, 29.09-05.10.2014		2
	11. Forumi Botëror i Demokracisë (World Forum for Democracy) në temën: „Re-wiring Democracy: connecting institutions and citizens in the digital age”, Këshilli i Evropës, Strasburg, Francë, 23-29.11.2013		2

	12. Seminar: „Policy making in practice”, School of Public Policy Mother Theresa , implemented by Center for Research and Policy Making, financed by the Council of Europe, Mavrovë, 30.05-02.06.2013	1	
	13. Seminar: „Multiculturalism and identity politics”, School of Public Policy Mother Theresa , implemented by Center for Research and Policy Making, financed by the Council of Europe, Ohër, 12-14.04.2013	1	
	14. Seminar: „Public Policy”, School of Public Policy Mother Theresa , implemented by Center for Research and Policy Making, financed by the Council of Europe, Ohër, 23-25.11.2012	1	
	15. Seminar: „NATO challenges after the Chicago Summit in 2012”, School of Public Policy Mother Theresa , implemented by Center for Research and Policy Making, financed by the Council of Europe, Ohër, 21-23.09.2012	1	
	16. Regional Conference “Regional Post – ISAF engagement - Lessons learned and a legacy for A-5 countries future expenditure missions”, Euro-Atlantic Council of Macedonia, Shkup, 11-13.12.2012		2
	17. "Shkolla për qytetari aktive (moduli i dytë)", realizuar nga FORUM-CSID, mbështetur nga FOSIM dhe USAID, Shkup, 08-10.06.2012	1	
	18. "Shkolla për qytetari aktive (moduli i parë)", realizuar nga FORUM-CSID, mbështetur nga FOSIM dhe USAID, Veles, 10-13.05.2012	1	
	19. „Volunteering and Community work for me”, Grundtvig program, Berlin, Gjermani, 02-09.10.2011		2
	20. „Research methods for the social sciences”, Pristina Summer University, Prishtinë, Kosovë, 12-23.07.2010		2
	21. „Common pathways against xenophobia“, Youth exchange, Kljuc, Bosnjë dhe Hercegovinë, 20.03-01.04.2010		2
	22. „Promoting European citizenship through media“, Training course (Action 3.1), Durres, Shqipëri, 24-30.11.2009		2
	23. „Seminar on Survey Methodology (certificate)“, University of New York - Tirana and Center for research and policy making, Shkup 25-27.06.2009	1	
	24. „International Summer University: “Language Courses”, AEGEE, (Zagreb, Rijeka, Zadar – Kroaci), 15-29.07.2009		2
	Gjithsej	9	30
2.	Moderator dhe drejtues i sesionit të konferencës/tribunës shkencore		
	1. Moderator i tribunës: „Milton Friedman Legacy for Freedom	0.5	

	Day”, organizuar nga Qendra për Kërkim dhe Zhvillim të Shoqërisë VIZIO, mbështetur nga EdChoice (Friedman Foundation for Educational Choice), 31.07.2016, Kërçovë		
	Gjithsej	0.5	
3.	Anëtar i komisioneve dhe organeve të shtetit dhe organeve/shoqatave të tjera		
	1. Anëtar i Kryesisë Rinore të Këshillit Euroatlantik të Republikës së Maqedonisë. www.atamacedonia.org.mk	1	
	2. Anëtar i Kryesisë së Institutit për Politika Publike – Shkup, www.ipp.org.mk	1	
	3. Anëtar i Shoqatës së Historianëve të Republikës së Maqedonisë, www.zirm.mk	1	
	4. Anëtar i Shoqatës së Sigurisë Kibernetike dhe Krijim të politikave GRATË NË KIBERNETIKË Shkup (Women4Cyber North Macedonia) www.women4cyber.mk	1	
	Gjithsej	4	
4.	Recensues i monografisë shkencore		
	1. Recensent i veprës shkencore të autorit Mr. Nexhad Mehmedoviq, me titull: „Macedonia at the annual general debate of the United Nations General assembly: (1993-2018)“, Institute for Public Policy, 2018	1	
	Gjithsej	1	
	Totali i pikëve nga tabela nr. 2	14,5	30
		44,5	

REFERENCAT KUMULATIVE PËR ZGJEDHJE NË THIRRJE SHKENCORE TË KANDIDATES, DR. FATIMA SALIFOSKA	Pikët
Veprimtaria shkencore-kërkimore dhe veprimtaria mësimore-shkencore (Pikët nga tabela nr.1)	75,0
Veprimtaria profesionale- e zbatueshme dhe veprimtaria e interesit më të gjerë (Pikët nga tabela nr.2)	44,5
GJITHSEJ	119,5

Shkup, më 6.9.2022

Komisioni recensues

Prof. dr. Sefer Tahiri – kryetar, d.v.

Doc. Dr. Valdet Kasapi - anëtare, d.v.

Prof. Dr. Ivanka Vasilevska - anëtare, d.v.

R E F E R A T**PËR ZGJEDHJEN E NJË ASISTENTI HULUMTUES NË DEPARTAMENTIN E TRASHËGIMISË SË GONXHE BOJAXHIUT – NËNËS TEREZE**

Në bazë të shpalljes së konkursit publik më 04.08.2022 në gazetata ditore “Lajm” dhe “Nova Makedonija” dhe në faqen e internetit të Institutit (www.itsh.edu.mk) për zgjedhje/rizgjedhje në thirrje bashkëpunëtoare - asistent hulumtues në Departamentin e Trashëgimisë së Gonxhe Bojaxhiut – Nënës Tereze, Këshilli i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, në seancën e tij të rregullt me nr. 187, të mbajtur më 22.8.2022, sipas vendimit me numër 0201-642/4 na për zgjodhi për anëtarë të Komisionit recensues në përbërje prej: dr. Elisabeta Ollogu - kryetar (“Universiteti Nënë Tereza” – në Shkup), dr. Avni Avdiu – anëtar (“Universiteti Nënë Tereza” në Shkup) dhe dr. Skender Asani - anëtar (Institutit i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup)

Si anëtarë të Komisionit Recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, Këshilli i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup ia paraqesim në vijim këtë:

RAPORT

Pasi që Komisioni Recensues e kontrollon dokumentacionin e dorëzuar, konstatoi se për zgjedhjen/rizgjedhjen e një asistenti hulumtues në Departamentin e Trashëgimisë së Gonxhe Bojaxhiut – Nënës Tereze në ITShKSh – Shkup, u paraqit vetëm një kandidat:

Mr. sc. Argëtim Raimi**1. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ARSIMIMI**

Argëtim Raimi ka lindur më datë 24.02.1994, në Kumanovë. Shkollën fillore e kreu me sukses të shkëlqyeshëm në Shkollën fillore “Bajram Shabani”, në Kumanovë. Gjimnazin e përgjithshëm e mbaroi në Gjimnazin “Sami Frashëri” në Kumanovë, me sukses të shkëlqyeshëm. Studimet Universitare i mbaroi në vitin 2016 në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Fakultetin Filozofik, Departamentin e Sociologjisë, me notë mesatare 8.5, në temën “Shoqëria civile si një ndër faktorët kyç në një shtet demokratik”. Po në këtë Universitet, në vitin 2019 mbaroi studimet e dyta universitare në Fakultetin e Ndërtimtarisë, ku mori titullin Inxhinier i Ndërtimtarisë.

Në vitin 2022 ai mbaroi studimet pas universitare në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup, në Departamentin e Punës dhe Politikës Sociale, me notë mesatare 10.00, me temë “Fenomeni i shkurorëzimit në RMV gjatë 10 viteve të fundit, me vështrim në Komunën e Kumanovës”, ku mori titullin Magjistër i Punës dhe Politikës Sociale.

Përveç punëve profesionale në ITSHKSH, ai merret edhe me aktivitete të shoqërisë civile si me OJQ-të (“ZANI” dhe “PRONA”), me të cilat kanë organizuar mjaft aktivitete të rëndësishme shoqërore. Argëtim Raimi ka qenë edhe recensent i disa librave të autorëve të njohur në fushën e filozofisë – sociologjisë (“Rrëfime Filozofike” nga Sunaj.R. dhe “Kultura Muzikore në Greqinë e Lashte”). Gjithashtu ai para disa ditësh ka botuar një punim shkencor në Revisten shkencore ndërkombëtare “ANAS”, Viti VII, Nr. 20, ISSN:1857-8896, Shkup, 2022.

2. PËRVOJA PROFESIONALE DHE PJESEMARRJA NË PROJEKTE, SEMINARE, WORK SHOPE

Kandidati Argëtim Raimi në të kaluarën, në cilësinë e themeluesit dhe bashkëpunëtorit në organizatat joqeveritare dhe jofitimprurëse “ZANI” dhe “PRONA”, ka arritur të organizojë dhe menaxhojë një sërë aktivitete civile të cilat kishin të bëjnë me liritë dhe të drejtat e njeriut, përmirësimin e jetës civile, mbrojtjen e ambientit jetësor në Kumanovë dhe gjetiu. Njohuritë dhe përvojën e arritur në Departamentin e Sociologjisë, ku ai kishte studiuar dhe diplomuar rreth temës për shoqërinë civile, Argëtim Raimi më vonë me zgjuarsin e aplikoi edhe në organizimin e të gjitha manifestimeve nga dy OJQ-të të cilat ai i (bashkë)drejtonte. Ndërkaq njohuritë e fituara në studimet Master të cilat kishin të bëjnë me fenomenin e shkurorëzimit në RMV, Argëtimi poashtu diti t’i përdor në teren për të mirën e zhvillimit dhe mirëqenies shoqërore në vend.

Këtu nuk duhet harruar edhe përvojën e tij si Inxhinier i Ndërtimarisë në mbikqyrjen dhe koordinimin e punëve menaxheriale në ndërmarrjen private “Arfifa” në Kumanovë, në të cilën brenda tri viteve sa kishte punuar, Argëtim Raimi kishte realizuar disa projekte të suksesshme. Ndërkaq Argëtim Raimi gjatë viteve të mëparshme ka frekuentuar edhe disa seminare dhe workshope në RMV, me të cilat e kishte zgjeruar dhe thelluar përvojën e tij profesionale shkencore.

Është me rëndësi të theksohet fakti se kandidati në fjalë, me përvojën e tij të larmishme profesionale Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve i ka sjellë një frymë të re në aspektin menaxherial, gjë e cila shihet në punën e tij të suksesshme të deritanishme në Sektorin për botime, kulturë dhe sport. Ai ka marrë pjesë aktive në të gjitha seminarët dhe manifestimet e organizuara nga ana e ITSHKSH-së dhe institucioneve tjera bashkëpunuese me këtë të fundit.

3. VEPRIMTARIA HULUMTUESE - SHKENCORE E KANDIDATIT

Kandidati mr. Argëtim Raimi deri më tani ka shkruar dhe botuar disa qasje sociologjike edhe në disa medime online, por si studim më i thelluar i tij mund të veçohet studimi i Masterit me temë “Fenomeni i shkurorëzimit në RMV gjatë 10 viteve të fundit, me vështrim në Komunën e Kumanovës”. Në këtë studim shkencor përveç

familjes, martesës dhe shkurorëzimit, shtjellohen edhe shkaqet, rrethanat dhe motivet e shkurorëzimit, me ç'rast iu jepet përgjigje edhe pyetjeve: Pse vie deri te prishja e martesave të sotshme? Cilët janë faktorët kryesorë që shpien kah shkurorëzimi? Cila është shkalla e shkurorëzimeve në RMV dhe Komunën e Kumanovës? Sa kanë institucionet tona qasje të duhur në trajtimin e shkurorëzimeve? Cilat janë masat preventive për ruajtjen e martesave dhe mosprishjen e tyre?

Sa i përket strukturës së këtij punimi master, ajo është ndarë në gjashtë kapituj kryesor. Në Kapitullin e parë përmbledhen arsyet e studimit të këtij fenomeni shoqëror dhe rëndësia e tij për shkencën dhe shoqërinë. Aty hasen qasjet e disa religjioneve për fenomenin e shkurorëzimit si dhe faktorët kryesorë të cilët sjellin deri te kjo dukuri sociale e dhembshme. Kapitulli i dytë i përfshinë funksionet themelore të familjes si dhe teoritë e ndryshme për familjen, ku flitet edhe mbi evoluimin e familjes dhe format e familjes nëpër histori. Në Kapitullin e tretë bëhet fjalë mbi shkaqet dhe pasojat e shkurorëzimit, ndikimin e faktorëve social, ekonomik dhe kulturor në shkurorëzimin e çifteve. Kapitulli i katërt i shtjellon disa çështje të së drejtës martesore dhe çështjes së shkurorëzimit në disa vende të Unionit European (Francë, Gjermani, Itali, Angli e Uells). Këtu jepet edhe një vështrim historik për të drejtat dhe obligimet e bashkëshortëve në RMV, si dhe Kosovë e Shqipëri si dy vende fqinje të RMV. Në Kapitullin e pestë shtjellohet thelbi i këtij studimi Master përmes pasqyrave tabelare e statistikore për të gjitha shkurorëzimet në RMV nga viti 2010-2020. Por, me këto tabelarë jepet edhe interpretimi i statistikave për shkurorëzimet në Komunën e Kumanovës, si dhe programet rehabilituese për çiftet para aktit të shkurorëzimit. Ndërsa në Kapitullin e gjashtë përfshihen të gjitha konkluzionet, këshillat dhe rekomandimet e shprehura lidhur me fenomenin e shkurorëzimit.

Përndryshe, këto ditë doli nga shtypi punimi shkencor i Argëtim Raimit me titull “Familja si bërthamë e shoqërisë dhe pjesët konsitutive të saj“ i botuar në Revistën shkencore ndërkombëtare “ANAS”, viti VII, Nr. 20, ISSN:1857-8896, Shkup, 2022.

4. VLERËSIMI I VEPRIMTARISË HULUMTUESE SHKENCORE TË KANDIDATIT ME RËNDËSI PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN SHKENCORE

Kandidati Argëtim Raimi gjatë hulumtimeve të tij shkencore e profesionale, sidomos në fushën e Sociologjisë ka arritur të sjellë prurje të reja për sa i përket çështjes së fenomenit të familjes, martesës, shkurorëzimit, zakoneve, paragjykimeve etj, të cilët janë të lidhura ngushtë me trashëgiminë tonë sociokulturore. Ndërkaq, sa i përket Departamentit të Gonxhe Bojaxhiut – Nënë Terezës, në të cilën kandidati pretendon ta zhvillojë veprimtarinë shkencore hulumtuese të tij të ardhshme, përvoja e tij modeste por mjaft ambicioze, premtion suksese të konsiderueshme edhe në fushën e hulumtimeve shkencore të cilat lidhen me jetën dhe veprën e Nënës Terezë.

Gjithashtu, këtu lipset theksuar se kandidati Argëtim Raimi ka shprehur një interesim të jashtëzakonshëm në pjesëmarrjen aktive tek të gjitha manifestimet,

seminaret dhe tribunat shkencore të organizuara për hirë të Gonxhe Bojaxhiut – Nënës tonë Terezë.

Duke e njohur përvojën, interesimin dhe synimin e kandidatit Argëtim Raimi që si një kuadër i ri shkencor i ITSHKSH-së në të ardhmen tërësisht t'i përkushtohet studimit të jetës dhe veprimtarisë humane të Nënës Terezë, ne jemi pëlotësisht të bindur se i njejti është një kuadër shumë shpresëdhënës në drejtimin dhe zhvillimin e këtij Departamenti të rëndësishëm të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore Kulturore të Shqiptarëve.

Kësaj pritshmërie tonë me siguri do t'i ndihmojë edhe kapaciteti gjuhësor i Argëtim Raimit, i cili përveç gjuhës amtare (shqipe), e shkruan dhe e flet shumë mirë gjuhën angleze dhe maqedone, ndërkaq e shkruan dhe e flet mirë gjuhën gjermane dhe turke. Këto adute i konsiderojmë si mjaft të rëndësishme për studimin dhe ruajtjen e trashëgimisë shpirtërore e kulturore të lënë nga Gonxhja jonë – Nëna Terezë.

5. PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Bazuar në të dhënat e paraqitura në këtë Raport recensues si dhe në bazë të aktiviteteve të shumta në planin shkencor, arsimor, profesional dhe aplikativ, Komisioni konstatoi se kandidati Argëtim Raimi deri më tani ka treguar vullnet, ambicie dhe përkushtim maksimal për avancimin e tij akademik, gjë që paraqet një bazë solide për punën dhe karrierën e tij profesionale të mëtutjeshme.

Andaj, në pajtim me Rregulloren për kushtet, kriteret, procedurën dhe mënyrën e zgjedhjes në thirrjet mësimore-shkencore dhe në pajtim me Ligjin për veprimtari shkencore dhe hulumtuese, Komisioni recensues i propozon Këshillit të Institutit ta zgjedh kandidatin Mr. Sc. Argëtim Raimi për ASISTENT-HULUMTUES në Departamentin e Trashëgimisë së Gonxhe Bojaxhiut – Nënës Tereze, në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup.

Shkup, 1.9. 2022

Komisioni recensues:

Dr. Elisabeta Ollogu, kryetare, d.v.

Dr. Avni Avdiu, anëtar, d.v.

Prof. dr. Skender Asani, anëtar, d.v.